



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_.\_\_.2021

**VENDIM**

**Nr. 326, datë 22.07.2021**

**PËR**

**TRANSFERIMIN E FONDEVE, NGA SHPENZIME PERSONELI, NË SHPENZIME PËR MALLRA DHE SHËRBIME TË TJERA, NË PROGRAMIN BUXHETOR “BUXHETI GJYQËSOR”, PËR VITIN 2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbështetje të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar, Udhëzimit nr. 9, datë 20.3.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe Udhëzimit Plotësues nr. 4, datë 25.01.2021 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2021” të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë, si dhe me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik dhe Administrimit të Buxhetit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë transferimin e fondeve buxhetore, duke pakësuar në Shpenzime Personeli (art.600, art.601), shumën prej 28,000,000 lekë, në buxhetin e Gjykatës së Lartë, dhe duke shtuar në Shpenzime për Mallra dhe Shërbime të tjera (art.602), shumën prej 28,000,000 lekë, në Shpenzime Korrente, në programin buxhetor 3310 “Buxheti gjyqësor”, në KLGJ.
2. Me zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Departamenti i Programimit dhe Administrimit të Buxhetit,

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**